



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 21 dhe 42 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik

Titulli i kontratës:

Ndërtimi i qendrës kulturore rinore në Mamushë

Numri i aktivitetit të prokurimit:

Nr i prokurimit	626-24-8441-5-1-1
Nr i brendshëm	626-24-020-5-1-1

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Çmimi total i ofertës
1.	"AXIS G.C.W." SH.P.K. Rr.Hyzri Talla Obj.16 H1 Nr.17-Fushë Kosovë, Kosovë	2112180.70 €
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik "TRIANGLE SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; HIDRO PROJECT SH.P.K. rr.Brigada123, Suharekë	1923423.00 €

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Komuna e Mamushës - Zyra e Prokurimit, shpërblen me kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët: TRIANGLE SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; HIDRO PROJECT SH.P.K. rr.Brigada123, Suharekë në vlerë totale të ofertës prej: 1923423.00 €

Data: 13.12.2024

Emri dhe mbiemri i ZPP: **Gazmend Gashi**

Nënshkrimi:

Këshillë juridike: Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj janë shkelur nga vendimi i autoritetit kontraktues gjatë kryerjes së këtij aktiviteti të prokurimit, mund të bëjë kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e Autoritetit Kontraktues, përmes platformës elektronike.

¹Ketij formulari bashkëgjatë me detyruesit standard të njohimeve: B42, B45 dhe B46. (shtoni letër njoftuese sipas nevojës).



Letër standarde për tenderuesin e eliminuar ²

Mamushë më: 13.12.2024

Komuna e Mamushës- Zyra e Prokurimit

Për: *Operatorin Ekonomik*: "AXIS G.C.W." SH.P.K. Rr.Hyzri Talla Obj.16 H1 Nr.17-Fushë Kosovë

Nr i prokurimit	626-24-8441-5-1-1
Nr i brendshëm	626-24-020-5-1-1

Titulli:

Ndërtimi i qendrës kulturore rinore në Mamushë

I nderuar Z. Valmir Ademaj

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Nuk e keni dorëzuar:

☐ Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara të cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;

☒ Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme të kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj;

☒ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbush kërkesat minimale të kapacitetit profesional, financiar dhe teknik të saktësuara në dosjen e tenderit apo në njoftimin e kontratës.

Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm:

☒ Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;

☐ Nuk e keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet *Formularin për dorëzimin e tenderit*.

☒ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;

☒ Nuk e keni paraqitur deklaratën për specifikimet teknike të objektit të ofruar të kontratës;

² Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt.

- ☐ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;
- ☒ Nuk e keni plotësuar numrin e kërkuar të punëtorëve dhe inxhinierëve.
- ☒ Nuk keni paraqitur dëshmitë e kërkuara për mjetet dhe pajisjet teknike për realizimin e kontratës.
- ☒ Nuk keni ofruar dëshmitë në lidhje me kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare
- ☒ Nuk e keni paraqitur planin dinamik për kryerjen e punëve sipas specifikimit teknik

[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik] N/A

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Në dosje të tenderit tek Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) në nenin 3.1 Specifikacionet teknike të detyrueshme është paraqitur kushti si vijon:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:

- a. Deklaratën për specifikacionet teknike për furnizimet (materiale) e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (Të plotësohet, nënshkruhet dhe vulloset aneksi nr. 7 i kësaj dosje të tenderit dhe të dorëzohet së bashku me tender).

Deklarata për specifikacion teknik është kërkesë administrative e paraparë në nenin 2.5 të dosjes së tenderit e cila obligon O.E. që të deklarojë se do të përmbahet specifikacioneve teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Ju me tenderin tuaj nuk keni dorëzuar një deklaratë të tillë.

Në dosje të tenderit tek Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) në nenin 5.2 afatet për fillimin dhe/ ose përfundimin e kontratës dhe në nenin III.1.3 të njoftimit për kontratë është paraqitur kushti si vijon:

-Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që të hartojnë dhe me tenderin e tyre të dorëzojnë planin dinamik për ekzekutim të kontratës sipas specifikave teknike të kërkuara në dosjen e tenderit. -Plani dinamik i punëve për gjithë projektin nuk duhet të jetë më i gjatë se dyqind e nëntëdhjetë (290) ditë pune. Për punët të cilat do të ekzekutohen në vitin 2024 plani dinamik nuk duhet të jetë më i gjatë se dyzetë (40) ditë pune ku do të ekzekutohen Punët e Pastrimit, Gërmimit dhe nivelizimit; Punët e Betonit dhe Armaturës dhe Punët e Hidroizolimit dhe termoizolimit (Shih planin e realizimit të punëve për vitin 2024 të bashkangjitur tek dokumentet e dosjes së tenderit) kurse për punët të cilat do të ekzekutohen në vitin 2025 nuk duhet të jetë më i gjatë se njëqind e pesëdhjetë (150) ditë pune për ekzekutimin e pozicioneve Punët e Betonit dhe Armaturës; Punët e muratimit dhe pllafonit; Punët e Kulmit dhe llamarines dhe Punët e Hidroizolimit dhe termoizolimit (Shih planin e realizimit të punëve për vitin 2025 të bashkangjitur tek dokumentet e dosjes së tenderit) dhe për punët që do të realizohen gjatë vitit 2026 nuk duhet të jetë më i gjatë se njëqind (100) ditë pune për ekzekutimin e pozicioneve Punët e muratimit dhe pllafonit; Punët e suvatimit, lysterjes dhe fasades së jashtme; Punët e Kulmit dhe llamarines; Punët e qeramikave, laminatit dhe mermerit; Punët e dyerve, dritareve dhe fasades strukturale; Punët e Oborrit; Punët e Tjera ; PUNËT E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT; HIDRANTËT; ELEMENTET SANITARE; ELEKTRIKA; TRUPAT NGROHËS FTOHËS DHE TUBACIONI; VENTILIMI dhe ASHENSORI (Shih planin e realizimit të punëve për vitin 2026 të bashkangjitur tek dokumentet e dosjes së tenderit).

-Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do të refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik.

Ju me tenderin tuaj nuk keni dorëzuar një afat të tillë.

Gjithashtu në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë në nenin 8.1 & 8.2 Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare në pikën 1 është paraparë kërkesa si vijon:

1. Operatorët Ekonomik duhet të kenë një qarkullim financiar së paku 3,000,000.00 € në tri vitet e fundit.

Dhe si dëshmi është kërkuar:

1. Raportin, raportet apo vërtetimet përkatëse nga një ose më shumë banka ose deklaratat vjetore në ATK apo nga institucioni kompetent në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilat dëshmohet se O.E ka pasur një qarkullim financiar në tri vitet e fundit sipas kërkesës së lartshënuar.

Grupi i O.E. nuk ka dorëzuar dëshminë për qarkullimin financiar sikur është kërkuar më lartë.

Gjithashtu në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale janë paraparë kërkesat si vijon:

1. Operatori ekonomik ose grupi i Operatoreve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte të ngjashme në tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontratë së paku në vlerë prej 2,250,000.00 (dy milion e dyqindpesëdhjetë mijë euro)

Dhe si dëshmi është kërkuar:

1. Lista e projekteve të realizuara për punë të ngjashme në tri vitet e fundit e cila duhet të përmbajë punët e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin e dëshmuar me "Referencë" ose "Raport" për realizimin me sukses të Kontratës. (i) Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i punës të tillë si dhe dëshmia për kryerjen e pagesës (transaksioni bankar, fatura etj).

Ju me tenderin tuaj keni dorëzuar listën e projekteve të realizuara gjatë tri viteve të fundit si dhe keni dorëzuar dëshmitë për realizimin e kontratave mirëpo nuk e keni mbërri vlerën e kërkuar prej 2,250,000.00 (dymilion e dyqindpesëdhjetë mijë euro)

Gjithashtu në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në pikën 2 janë paraparë kërkesat si vijon:

Kërkesa 2. OE duhet të kenë staf të mjaftueshëm të punëtorëve dhe inxhinierëve të kyçur në projekt, 2.1 O.E. duhet të caktoj me deklaratë të qartë ose me vendim menaxherin e kontratës për këtë projekt, i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master të përfunduar (drejtimi konstruktiv), të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. I certifikuar për mbrojtje nga zjarri dhe specialist për organizimin dhe menaxhimin e kantierëve të ndërtimit. 2.2 O.E. duhet të caktoj me vendim udheheqesin e punishtes, i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master të përfunduar (drejtimi konstruktiv), të ketë së paku 10 (dhjet) vite përvojë pune. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë, i certifikuar për rrezikun në lartësi, i certifikuar për mbrojtje nga zjarri dhe specialist për organizimin dhe menaxhimin e kantierëve të ndërtimit. 2.3 Një

(1) inxhinier të diplomuar ose master Drejtimi Arkitekture, kërkohet të ketë min. 3 vite përvojë pune në angazhime profesionale pas diplomimit i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë dhe i certifikuar për mbrojtje nga zjarri. 2.4 Një (1) inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master të përfunduar (drejtimi Infrastrukturë rrugore), kërkohet të ketë min. 8 vite përvojë pune në angazhime profesionale pas diplomimit i certifikuar për menaxhimin e projekteve dhe të jete i pajisur me Certifikatë për siguri rrugore. 2.5 Një (1) inxhinier të diplomuar ose master drejtimi Hidroteknik, kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit dhe të ketë menaxhuar së paku një projekt dhe të ofroj dëshmi për një menaxhim të tillë. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. I certifikuar për mbrojtje nga zjarri I certifikuar me ISO 9001 2015- I certifikuar me ISO 500001 2018 si dhe të jetë Ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis. 2.6 Një (1) inxhinier i Elektros, kërkohet të ketë së paku 5 vite përvojë pune i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. I certifikuar për mbrojtje nga zjarri. 2.7 Një (1) inxhinier ose bachelor për Menaxhimin e emergjencave me së paku 5 vite përvojë pune, i trajnuar për siguri dhe shëndetin në punë dhe mbrojtje nga zjarri. 2.8 Një (1) inxhinier të diplomuar ose bachelor i Ndërtimtarisë drejtimi Inxhinieri e Ambientit, kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit. 2.9 Një (1) inxhinier të diplomuar ose bachelor drejtimi Gjeodezi, i licencuar me licence valide, kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit. 2.10 Një (1) Teknik i ndërtimtarisë. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. I certifikuar për mbrojtje nga zjarri. 2.11 Një (1) Specialist për Sigurimin dhe Kontrollin e Mjedisit në Kantier. 2.12 Një (1) Ekspert të certifikuar për sistemet e drenazhimit. I certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. I certifikuar për mbrojtje nga zjarri. 2.13 Një (1) Ekspert të certifikuar për Siguri në punë në lartësi dhe përdorimi i Pajisjeve Personale Mbrojtëse 2.14 Min Një (1) punëtor të certifikuar si hidroinstalues, ujësjellës, kanalizim si dhe të jetë i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë si dhe mbrojtje ndaj zjarrit dhe i certifikuar për rrezikun në lartësi. 2.15 Min Një (1) punëtor të certifikuar Latues si dhe të jete i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë si dhe për mbrojtje ndaj zjarrit dhe i certifikuar për rrezikun në lartësi. 2.16 Min Një (1) punëtor të certifikuar për Suvatim si dhe të jetë i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë si për mbrojtje ndaj zjarrit . 2.17 Min Një (1) punëtor të certifikuar Murator si dhe të jetë i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë si dhe për mbrojtje ndaj zjarrit . 2.18 Një (1) person të certifikuar për sigurimin dhe kontrollin e mjedisit në kantier. 2.19 OE duhet të ketë së paku dhjetë (10) punëtorë të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë si dhe të jenë të certifikuar për mbrojtje nga zjarri.

Dhe si dëshmi është kërkuar:

2. Lista origjinale e punëtorëve të O.E. nënshkruar dhe vulosur nga O.E. 2.1-2.2 Vendimi për caktimin e menaxherit të projektit dhe udhëheqësin e punishtes (Origjinal ose Kopje e noterizuar) Diplomat, certifikatat e inxhinierit (kopje të noterizuar) Diplomat jashtë shtetit duhet të jenë të nostrifikuara) -Cv-të e inxhinierëve të nënshkruar nga inxhinieri (origjinal ose kopje të noterizuar) 2.3-2.8. Diplomat, Certifikatat e noterizuara të inxhinierëve, CV-të e përshkruar qartë me eksperiencën e kërkuar të nënshkruar nga inxhinierët (origjinal ose kopje të noterizuara) 2.9 Për gjeodetin, diploma e noterizuar, , kontratën dhe CV-në të përshkruara qartë me përvojën e kërkuar të nënshkruar nga vetë inxhinieri (origjinal ose kopje e vërtetuar) dhe një kopje të licencës. 2.10 -2.11 Diploma, Certifikatat e teknikut dhe specialistit kantierit (kopje të noterizuar). -Cv-të e nënshkruar nga tekniku (origjinal ose kopje të noterizuar) 2.12 Për Ekspert të certifikuar për sistemet e drenazhimit, kontratën dhe CV-në dhe kopje të certifikates 2.13 Për Ekspert të certifikuar për Siguri në punë në lartësi dhe përdorimi i Pajisjeve Personale Mbrojtëse, kontratën dhe CV-në dhe kopje të certifikates 2.14-2.18 Diploma-Certifikatat e punëtorëve (kopje të noterizuar) si dhe kontratat e punës ose parakontrate në emer të projektit,. 2.19 Për-10 punëtorë të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë, dhe për mbrojtje nga zjarri Certifikatat të noterizuara si dhe kontratat e punës ose parakontrate në emer të projektit, 2.20 Për- stafin teknik të prezantohen-kontratat e punës ose parakontrata origjinal dhe certifikatat e noterizuara nga origjinali.

Ju nuk keni paraqitur listën e punëtorëve si dhe nuk keni dorëzuar dokumentet dëshmuuese të stafit sikur është kërkuar më lartë.

Gjithashtu në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në pikën 3 janë paraparë kërkesat si vijon:

Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 8 të DT.

Dhe si dëshmi është kërkuar:

3. Dëshmi Mbi pronësinë (apo marrëveshje te marrjes me qira) të mjeteve, librezat e qarkullimit dhe Deklaratat Unike Doganore ose faturat e blerjes për ato automjete që nuk kanë librezat e qarkullimit. Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar me vërtetim nënshkrimi në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Ju me tenderin tuaj nuk keni dorëzuar Listën e pajisjeve sipas aneksit nr. 8 si dhe nuk keni dorëzuar dëshmitë për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit.

Gjithashtu në pikën 4. është paraqitur kërkesa 4. Raporti i vlerësimit të riskut në vendet e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për Siguri dhe shëndet në punë.

Dhe si dëshmi është kërkuar:

Dëshmia 4. Kopja e raportit të vlerësimit të riskut në vendet e punës, kopja licencës së kompanisë së licencuar për ushtrimin e punëve nga siguria dhe shëndeti në punë. Në rast koncersiumi lideri duhet të ketë Raportin e vlerësimit të riskut.

Ju me tenderin tuaj nuk keni paraqitur fare raportin për vlerësimin e rriskut, andaj nuk e keni plotësuar dëshminë sikur është kërkuar më lartë.

Gjithashtu në pikën 5. është paraqitur kërkesa 5.-Certifikim 1. ISO 45001 2018-Sistemi i Menaxhimit te Sigurisë dhe Shëndetit ne Pune. 2. ISO 9001 2015-Sistemi i menaxhimit te Cilësisë 3. ISO 14001 2015-Sistemet e menaxhimit të Mjedisit. 4. ISO 39001 2012-Sistemet e menaxhimit të Sigurisë në trafikun Rrugor , 5. ISO 50001 2018 Certifikata për sistemin e menaxhimit te energjisë, 6. ISO 6892 2019 Sistemi i menaxhimit të materialeve metalike, 7. ISO 3834-2 2021 Sistemi I menaxhimit te cilësisë se saldimit te materialeve metalike. 8. ISO 28001 2007 Sistemi i menaxhimit të sigurisë për zingjirin e furnizimit.

Dhe si dëshmi është kërkuar:

Dëshmia 5- Qertifikatat të jenë valide dhe të noterizuara nga origjinali jo më larg se gjashtë (6) muaj nga data e njoftimit për kontratë.

Ju me tenderi tuaj keni paraqitur dëshmitë vetëm për certifikatat: ISO 9001 2015-Sistemi i menaxhimit te Cilësisë. ISO 14001 2015-Sistemet e menaxhimit të Mjedisit dhe ISO 45001 2018-Sistemi i Menaxhimit te Sigurisë dhe Shëndetit ne Pune, ndërsa për certifikimet tjera nuk keni dorëzuar dëshmitë e kërkuara.

Gjithashtu në pikën 6. është paraqitur Kërkesa 6. Kërkesa 6.1 - OE duhet të ketë bazë për prodhimin e betonit në pronësi apo marrëveshje për furnizim me beton dhe të dëshmoj se baza për prodhimin e betonit i ka certifikatat e përditësuara. Kërkesa 6.2- OE duhet të ketë bazë për prodhimin e asfaltit në pronësi apo marrëveshje për furnizim me asfalt dhe të dëshmoj se baza për prodhimin e asfaltit i ka certifikatat e përditësuara dhe të jetë i certifikuar me CE në bazë të licencës konform standardit EN 13108, dhe EN 12697 për prodhimin e asfaltit, AB11,BZH22

Dhe si dëshmi është kërkuar:

Dëshmia 6.1 - Kopja e Lejes për aktivitet të veçantë të lëshuar nga Agjencioni për miniera dhe minerale. Në rastet kur OE ka marrëveshje për furnizim, OE duhet të dorëzojë edhe kopjen e marrëveshjes të noterizuar për furnizim. Dëshmia 6.2 - Kopja e Lejes për aktivitet të veçantë të lëshuar nga Agjencioni për miniera dhe minerale. Në rastet kur OE ka marrëveshje për furnizim, OE duhet të dorëzojë edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim të noterizuar si dhe certifikatat për prodhim të asfaltit të noterizuar jo më largë se gjashtë (6) muaj nga data e njoftimit për kontratë.

Ju me tenderin tuaj nuk keni dorëzuar kopje të lejeve për bazë të asfaltit dhe bazë të betonit sikur është kërkuar më lartë.

Në dosje të tenderit tek Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) në nenin 13.2 dhe në njoftimin për kontratë në nenin IV.3.4) është kërkuar që tenderuesit me tenderin e tyre të dorëzojnë sigurimin e tenderit në vlerë prej 25,000.00 € të vlefshëm për 150 ditë nga data e dorëzimit të tenderit.

Ju me tenderin tuaj nuk keni dorëzuar sigurimin e tenderit sikur është kërkuar më lartë.

Në dosje të tenderit tek Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) në nenin 21.1 dhe në njoftimin për kontratë në nenin IV.3.5) është kërkuar që tenderuesit të japin vlefshmërinë e ofertës për një periudhë prej 120 ditëve nga data e dorëzimit të tenderit.

Ju keni ofruar një vlefshmëri të ofertës tuaj për një periudhë prej nëntëdhjetë (90) ditëve.

Lëshimet e cekura më lartë kanë bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qenë në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Gazmend Gashi

(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)


(Nënshkrimi)



B45 - Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm³

Mamushë më: 13.12.2024

Komuna e Mamushës- Zyra e Prokurimit

Për: Grupin e Operatorëve Ekonomik TRIANGLE SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K.;
HIDRO PROJECT SH.P.K. rr.Brigada123, Suharekë

Nr i prokurimit	626-24-8441-5-1-1
Nr i brendshëm	626-24-020-5-1-1

Titulli: Ndërtimi i qendrës kulturore rinore në Mamushë

I nderuar z. Arian Bytyçi

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”. Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**, si përgjigje ndaj **kërkesës për tenderin në lidhje me** aktivitetin e prokurimit të lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit*.

Bashkëngjitur me këtë letër është vendimi për dhënie të kontratës

Me respekt,

Gazmend Gashi

Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit


Mënshkrimi

³ Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata